

Për të disatën herë arsimit shqiptar shkel laicitetin me këmbët e veta, duke trajtuar subjekte fetare në tekstet mësimore. Teksti i mëposhtëm është marrë nga matematika e klasës së parë, hartuar nga Diana Starja dhe Zenepe Shkoza, duke ilustruar ushtrimet me informacione mbi festat fetare të krishtera.

Ushtrimi gjendet në faqen 129:

*«Krishtlindjet vitin tjetër do të jenë të dielën.
Kjo është një ngjarje e mundur.
Krishtlindjet vitin tjetër do të jenë në 31 dhjetor.
Kjo është një ngjarje e pamundur.
Pashkët do të jenë të dielën.
Kjo është ngjarje e sigurt.»*

Teksti i në fjalë të krijon idenë se duhet t'i përkasë një shkolle fetare, përderisa edhe ilustrimet priret t'i gjejë në fushën e fesë, e madje ekskluzivisht në një fe të vetme. Nuk e dimë përse autorët kanë preferuar t'i kërkojnë shembujt e ilustrimeve të tyre tek festat fetare dhe përse pikërisht vetëm tek një fe. Ndoshta gjithçka mund të ketë ardhur në mënyrë të pavullnetshme, por gjithsesi edhe kjo ilustron shumë mirë klimën e pabarazisë fetare që është ndërtuar në Shqipëri gjatë këtyre viteve, ku Islami përjashtohet dhe madje cenohet vazhdimisht nga institucionet publike, ndërsa katolicizmi në veçanti, e krishterimi në përgjithësi, promovohet në kundërshtim të plotë me parimet e laicitetit.

Në kushtet kur ndeshemi me një prirje sistematike për marginalizim të Islamit nga institucionet publike, nuk mund t'ia lejojmë vetes luksin të mos vëmë re paralelisht një prirje të vazhdueshme për të kristianizuar hapësirat publike, të cilat mbeten «zonë e ndaluar» për muslimanët. Kemi para sysh këtu një mori rastesh të denoncuar në blogun tonë, ku janë evidentuar shkelje flagrante të laicitetit dhe barazisë fetare, por edhe një sërë fenomenesh të cilat i ndeshim haptas, si urimet e krishtlindjeve në/nga institucionet shtetërore, organizimi i ceremonive festive të krishtlindjeve në/nga kopshtet e shkollat tona «laike», organizimi i ceremonive përkujtimore e festive në ditën e lumturimit të Nënë Terezës, të pasuruar shpesh me recitime vjershash me tematikë të mirëfilltë fetare në mjedise shkollore, shndërrimi i Kuvendit Popullor në sallë celebrimi të festave të fundvitit, ndërkohë që laikisht kemi një festë fundiviti, “spastrimin” e personazheve të klerit islam nga listat e panteonit kombëtar, shndërrimin e përfaqësive diplomatike në mekanizma promovimi të figurave dhe aktivitetit kishtar, e mbase Ambasada e “jonë” në Romë dhe xhepi i saj në Milano kryesojnë në këtë sport sepse janë dëmtuar nga fusha elektromagnetike e antenave përreth.

Në Shqipëri janë bërë të shpeshta rastet e misionarëve të krishterë që shpërndajnë fletushka e libra në mjediset shkollore. Tekstet mësimore janë të pasura me fragmente që nuk ngurrojnë të shfaqin hapur anësinë e tyre fetare, ku, teksa mbrohen si shkencore pikëpamje doktrinale të krishterimit, Islami paraqitet nëpërmjet tezave më anti-muslimane në qarkullim. Gjithashtu teksa vajzat muslimane me shami nuk lejohen të frekuentojnë shkollat publike (megjithëse nuk ka asnjë ligj që i ndalon, të gjithë drejtorët e shkollave i binden në unison urdhërave nën zë për moslejimin e tyre), muret e mjaft institucioneve arsimore në Shqipëri tapicohen me portrete të një gruaje me shami, por me një fe tjetër, të cilës ia festojmë edhe lumturimin: me sa duket për institucionet arsimore shqiptare laiciteti është vetëm për nxënësit e jo për shkollën. Shkolla ka të

drejtë ta promovojë shaminë kur është katolike, ka të drejtë të festojë festa fetare, të promovojë figura fetare, madje edhe të predikojë vlerat e krishterimit nëpër tekstet mësimore, ndërsa nxënësit fetarë nuk kanë të drejtë të hyjnë në shkollë, nëse janë të dallueshëm publikisht se janë të tillë.

Në fakt shteti shqiptar po i jep vetes të drejtë t'i trajtojë grupet fetare në mënyrë të diferencuar: disa të vetët e disa të njerkës. Ky dopio-standard është i rrezikshëm, jo shumë për muslimanët, por më shumë për vetë shoqërinë, e cila po shkon drejt krijimit të konfliktualiteteve fetare krejt të panevojshme. Nëse një grup i madh social marginalizohet dhe krijon perceptimin se shteti është armiqësor për ta, kjo përbën natyrisht një kërcënim të ekuilibrave socialë. Mund të shkaktojë izolim dhe reagime kolektive që refuzojnë kontratën me shtetin, që kërkojnë zgjidhje përtej kësaj kënete politike. Mund të shkaktojë një antipolitikë të pastër. Jo se kjo klasë politike nuk e meriton të refuzohet në bllok, por të paktën qytetarët duhet të besojnë tek roli i shtetit-garant. Mirëpo në këtë mënyrë pu-shteti po neutralizon edhe besimin bazik ndaj tij.

Shteti shqiptar është krejtësisht gafil për të kuptuar efektin negativ të këtyre dukurive, por më e keqja është se akoma më gafil është Komuniteti Musliman, i cili nuk ka, deri më tani, asnjë reagim për raste të tilla, e as kur vihet në dijeni nga xhematet apo edhe media të ndryshme. Ne kemi bërë disa denoncime si këto, por nuk kemi konstatuar veprime konkrete nga KMSH. Nëse Komuniteti Musliman nuk e ndjen këtë për detyre, nuk di se çfarë detyre mund të ketë tjetër, përveç pritjes së ambasadorëve. Nuk ka asnjë arsye pastaj për t'u habitur kur dalin grupe që radikalizohen e më pas nuk e njohin KMSH-në. Natyrisht, kur KMSH nuk ka interes të mbrojë bashkësinë dhe fenë e vet nga shkeljet dhe padrejtësitë, besimtarët kanë të drejtë të ndjehen të braktisur./e-zani/